



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar Primiçeno/Prodato Received/Delivery	07.12.2020	viti god year	
Organ /Mjesta Organ /Jedinstva Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Pislog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	2994/2020		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.320/2020

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Jeton Koca, anëtar, Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 320/2020 të datës 27.10.2020 ka shqyrtuar ankesën e parashtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar Kerveshi & Partners me adresë: Rruga B, C15 /10 Nr.2 në Prishtinë, për grup ankuesish [redacted], organit të punësimit Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 07.12.2020 mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën me numër Anr. 320/2020 të datës 27.10.2020 të parashtruar nga grup ankuesish: [redacted] dhe [redacted].

A r s y e t i m

Ankuesit: [redacted] e caktuar në pozitën e ushtruese e detyrës së Drejtorit të Shkollës Fillore dhe të Mesme të Ulët “Mustafa Baku” në Prizren, [redacted] e caktuar në pozitën ushtruese së detyrës së Drejtorit të Institucionit edukativ-arsimor të Shkollës Fillore “Lekë Dukagjini” në Prizren, [redacted], e caktuar në pozitën ushtrimin e detyrës së Drejtorit të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “Besim Ndrecaj” në Prizren; [redacted] i caktuar në pozitën ushtrimin e detyrës së Drejtorit të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “Haziz Totaj”, në Prizren; [redacted] i caktuar në pozitën e ushtrimit të detyrës së Drejtorit të Shkollës Fillore të Mesme të Lartë “Remzi Ademi”, në Prizren dhe [redacted], i caktuar në pozitën e ushtrimit të detyrës së Drejtorit të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “Dëshmorët e Hasit”, në Kabash te Hasit-Prizren, në bazë të Vendimeve të Kryetarit të Komunës.

Kryetari i Komunës së Prizrenit, me Vendimin e datës 13.08.2020, ankuesit i ka njoftuar se nuk mundë të ushtrojnë më tutje pozitën si ushtrues në detyrë në Institucionet e lartë cekuar, duke obliguar Drejtorin e Arsimit, që të marr veprimet ligjore për sistemimin e tyre në vendin e punës përkatësisht në profilin përkatës sipas nenit 10 të Udhëzimit Administrativ me numër 15/2019 të MASHT.

Ankuesit kundër Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, kanë parashtruar ankesë me datë 24.08.2020 tek Këshillit drejtues i shkollës në Komunën e Prizrenit.

Ankuesit, e pa kënaqur në mos marrjen e përgjigjes në ankesën e datës 24.08.2020, të parashtruar kundër Vendimin të datës 13.08.2020 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, kanë parashtruar ankesë përmes përfaqësuesit të autorizuar Kerveshi & Partners në Prishtinë, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.10.2020 me numër protokollit 2274/2020, me pretendime ankimore për anulimin e vendimeve të Kryetarit të Komunës së Prizrenit lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesve, si drejtor të institucioneve shkollore.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesë e datës 27.10.2020 e parashtruar nga grup ankuesish në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 12.08.2020; Vendimi nr.140/20 i datës 12.08.2020; Vendimi nr.133/20 i datës 12.08.2020; Vendimi nr.134/20 i datës 12.08.2020; Vendimi nr.135/20 i datës 12.08.2020; Vendimi nr.137/20 i datës 12.08.2020; Vendimi nr.136/20 i datës 12.08.2020; Vendimi nr.01-112-6022 i datës 15.01.2020; Vendimi nr.144/20 i datës 13.08.2020; Vendimi nr.142/20 i datës 13.08.2020; Mirënjohje; përformac e punës i datës 10.01.2017; përformac e punës i datës 18.02.2016; përformac e punës i datës 22.02.2016; Vërejtje me shkrim i datës 10.05.2018; Ankesë/peticion i datës 24.08.2020; Ankesë e datës 24.08.2020; Kërkesë e datës 19.08.2020; Vendimi datës 24.01.2014; Vendim i datës 30.01.2014.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesat e parashtruara nga ankuesit: [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj çështjeje pasi që marrëdhënia e punës e ankuesve nuk rregullohet me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, siç e përcakton dispozita e nenit 3 paragrafi 5, ku përcaktohet se: "Ky ligj, gjithashtu, nuk zbatohet për personelin e ndërmarrjeve publike, në pronësi të Qeverisë apo të një komune, për të cilat marrëdhënia e punës rregullohet me legjislacionin e punës", dhe e drejta e informimit dhe ankimit është e përcaktuar në nenin 24 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, ku përcakton se: "Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente", që në rastin konkret Vendimet e datës 12.08.2020 për ndërprerjen e kryerjes së punës së ushtruesve në detyrë të Drejtorive të Institucioneve Shkollore, në Komunën e Prizrenit, janë nxjerrë në bazë të dispozitave të Ligjit për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe Udhëzimit Nr.15/2019 Administrativ të MASHT-it, dhe për të drejtën e animimit janë udhëzuar për Komisionin e parashtrësve dhe të ankesave në Komunën e Prizrenit..

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur në ankesat e ankuesve dhe i udhëzon ankuesit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e nenit 24 paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat ligjore të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për pranim në shërbimin civil, siç është përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3.

Andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi që ka shpallë jo-kompetencën e Këshillit për të vendosur lidhur me ankesat e ankuesve, konstaton se ankuesit të drejtën e tyre mund ta realizoj në pajtim me dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore, me të cilat rregullohet marrëdhënia e punës për kategoritë nëpunësve të administratës të cilët janë të përjashtuar nga shërbimi civil, në pajtim me afatet e përcaktuara me Ligjin e Punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, bazës ligjore të aplikuar në lidhje me këtë çështje administrative si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit sipas nenit 10.1 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ANR. 320/2020



Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar Kerveshi & Partners
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunë të Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

